

Dr. Tony B. Watlington Sr., Ed.D.
Superintendent

30 Gusht, 2022

Të Dashur Familje dhe Studentë të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Dje, drejtuesit dhe mësuesit e shkollës sonë, së bashku me shumë anëtarë të tjerë të personelit, i ranë ziles për vitin e ri shkollor, duke i ndihmuar të rinjtë tanë të ndihen të mirëpritur, dhe të vlerësuar. Sa e mrekullueshme dita e parë e shkollës!

E nisa ditën time në një nga qendrat e autobusëve tanë të shkollës dhe dëgjova drejtpërdrejt nga drejtuesit e autobusëve dhe ekipi i transportit se sa të emocionuar janë ata për të mirëpritur dhe mbështetur studentët tanë këtë vit të ri shkollor. Ata folën për buzëqeshjet në fytyrat e të rinjve tanë dhe gëzimin e rilidhjes së studentëve pas një vere të gjatë. Nuk mund të pajtohesh me shumë dhe kjo është pikërisht ajo që përjetova sot.

Gjatë gjithë ditës, pata kënaqësinë të vizitoja gjashtë shkolla, secila me një histori të ndryshme dhe mahnitëse. Shkolla Paul Dunbar, një nga shkollat tona të reja komunitare, që shtroi tapetin e kuq për studentët, të cilëve iu bashkuan edhe nxitësit e tifozëve dhe lojtarët e futbollit të Temple Universiteti. Gloria Casarez Elementary e sapo riemërtuar mbajti festën e riemërtimit, duke varur jashtë flamurin "PRIDE" me personelin, studentët dhe familjet në festë për nder të të gjitha kontributeve të shkollës. Tre vizitat e mia të ardhshme në shkollë shfaqin një gamë të gjerë të programeve arsimore që Drejtoria ofron për nxënësit:

- Thurgood Marshall Elementary me Programin e "New International Baccalaureate Middle Years",
- Strawberry Mansion me Programet e Culinary Arts, Graphic Arts and Music Production ;
- dhe Akademia at Palumbo me Programin e saj të "robotics and STEM focus".

E përfundova ditën time duke përjetuar të qeshurat e studentëve gjatë pushimit nga shkolla në shkollën John Patterson. Këto shkolla janë vetëm një shembull i vogël i gëzimit që ishte i dukshëm në shkollat anembanë Drejtorisë Mezi pres të kaloj më shumë kohë në shkollat tona këtë javë.

Sinqerisht, ne disa nga shkollat që vizitova sot kishte vapë, sepse ato janë në 100 të shkollave në drejtorinë tonë pa sisteme të mjaftueshme ftohjeje. Ndërsa Ekipi ynë i Operacioneve instaloi 500 njësi të ajrit të kondicionuar këtë verë, ne do të vazhdojmë të përdorim burimet tona të disponueshme për të instaluar më shumë dhe për të rishikuar dhe përditësuar protokollet tona të motit ekstrem.

Jam gjithashtu i kënaqur që kemi arritur një zgjidhje për kontratën me 32BJ e cila përfaqëson 2000 punonjës të transportit, pastrimit dhe mirëmbajtjes. Kjo do të thotë se është shmangur mundësia e një greve. Unë kam një respekt dhe njohje të jashtëzakonshme për këta individë dhe besoj se kjo kontratë rikonfirmon kontributin dhe vlerën e tyre për Drejtorinë tonë.

Me fillimin e këtij viti të ri shkollor, ne të gjithë presim me padurim atë që ka më shumë rëndësi - të mirëpresim studentët tanë dhe të krijojmë një mjedis mësimor pozitiv dhe të kujdesshëm për ta çdo ditë duke ecur përpara. Mezi pres ta bëj këtë në bashkëpunim me ju.

Sinqerisht!



Tony B. Watlington Sr., Ed.D.
Superintendent
Drejtoria Arsimore e Filadelfias